

PDS-ICD-11

Ju lutem që për secilën fushë të selektoni nga një prej fjalive që ju përshkruan më së miri në përgjithësi

1. Identiteti

- ☐ Shpesh nuk e kam sensin se kush jam, sidomos kur jam me njerëz të tjerë
- ☐ Ndonjëherë jam i hutuar se kush jam, sidomos kur jam me njerëz të tjerë
- ☐ Unë e kam një sens të qëndrueshëm se kush jam
- ☐ Sensi im rreth asaj se kush jam është në përgjithësi shumë i fiksuar dhe i kufizuar (p.sh., në lidhje me punën ose me një person tjetër)
- ☐ Sensi im rreth asaj se kush jam është tejet i kufizuar dhe i pandryshueshëm, pavarësisht rrethanave

2. Vetë-vlerësimi

- ☐ Shumicën e kohës ndihem i/e pavlerë, gjë që e ndikon mënyrën se si lidhem me njerëzit e tjerë
- ☐ Shpesh e kam të vështirë të ndjehem mirë për veten time, gjë që nganjëherë e ndikon mënyrën se si lidhem me njerëzit e tjerë
- ☐ Zakonisht ndihem mirë për veten time
- ☐ Shpesh ndjehem që jam më i mirë se të tjerët, gjë që e ndikon mënyrën se si lidhem me njerëzit e tjerë
- ☐ Unë ndjehem superior në krahasim me të tjerët, gjë që e ndikon mënyrën se si lidhem me njerëzit e tjerë

3. Vetë-perceptimi

- ☐ Unë nuk kam pika të forta
- ☐ Unë kam pak pika të forta
- ☐ Unë e kam një sens të mirë të pikave të mia të forta dhe të dobëta
- ☐ Unë kam pak pika të dobëta apo limitime
- ☐ Unë nuk kam pika të dobëta apo limitime

4. Qëllimet

- ☐ Rrallë mundem të vendos dhe të ndjek qëllimet e mia
- ☐ Nganjëherë më duket e vështirë të vendos dhe të ndjek qëllimet e mia
- ☐ Unë nuk e kam problem të vendos dhe të ndjek qëllime reale
- ☐ Ndonjëherë më duket e vështirë të ndryshoj qëllimet e mia, edhe nëse do të jetë tepër e vështirë t'i arrij ato
- ☐ Mua më duket rregullisht e vështirë t'i ndryshoj qëllimet e mia, edhe nëse do të jetë gati e pamundur që t'i arrij ato

5. Interesimi për marrëdhënie

- ☐ Unë nuk kam interesim të jem me të tjerët dhe bëj gjithçka që t'u shmangem atyre
- ☐ Unë kam pak interesim që të jem me të tjerët dhe prandaj u shmangem atyre
- ☐ Unë e kam një balanc të mirë në mes të qëndrimit vetëm dhe me të tjerët
- ☐ Nganjëherë ndihem i/e mërzitur kur nuk kam njerëz rreth vetes
- ☐ Shpesh ndihem i/e mërzitur kur nuk kam njerëz rreth vetes

6. Marrja e perspektivës

- ☐ Nuk mendoj asnjëherë për mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve
- ☐ Shpesh nuk mendoj për mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve
- ☐ E kam të lehtë të lidhem me mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve
- ☐ Shpesh mendoj tepër shumë rreth asaj se si mendojnë dhe si ndihen të tjerët
- ☐ Gjithmonë mendoj tepër shumë rreth asaj se si mendojnë dhe si ndihen të tjerët

7. Reciprociteti në marrëdhënie

- ☐ Njerëzit e tjerë gjithmonë ankohen që unë jam tepër vetjak/e në marrëdhënie
- ☐ Njerëzit e tjerë janë ankuar ndonjëherë që unë jam tepër vetjak/e në marrëdhënie
- ☐ Unë jam në gjendje që të krijoj dhe të mirëmbaj marrëdhënie të afërta dhe të kënaqshme për të dy palët
- ☐ Ndonjëherë nuk jam në gjendje t'u jap fund marrëdhënieve, edhe nëse janë të dëmshme për mua
- ☐ Unë jam rrallë në gjendje t'u jap fund marrëdhënieve, edhe nëse janë të dëmshme për mua

8. Menaxhimi i mosmarrëveshjeve

- ☐ Shpesh hyj në mosmarrëveshje me të tjerët, që shkaktojnë probleme serioze në marrëdhënie
- ☐ Ndonjëherë hyj në mosmarrëveshje me të tjerët, që shkaktojnë probleme në marrëdhënie
- ☐ Jam në gjendje t'i menaxhoj mosmarrëveshjet në marrëdhënie në mënyrë bashkëpunuese
- ☐ Shpesh u shmangem mosmarrëveshjeve duke ua lëshuar rrugën të tjerëve, edhe nëse më bie keq
- ☐ Unë u shmangem mosmarrëveshjeve dhe konflikteve me të tjerët me çdo kusht

9. Kontrolli dhe shprehja e emocioneve

- ☐ Shpesh nuk mund t'i kontrolloj emocionet e mia, gjë që shkakton probleme serioze me të tjerët
- ☐ Nganjëherë e kam të vështirë t'i kontrolloj emocionet e mia, gjë që shkakton disa probleme me të tjerët
- ☐ Në përgjithësi jam në gjendje të kontrolloj dhe të shpreh emocionet e mia në një mënyrë të përshtatshme
- ☐ Nganjëherë njerëzit ankohen që unë nuk i shpreh emocionet e mia
- ☐ Njerëzit shpesh ankohen që unë nuk i shpreh asnjëherë apo nuk i shpreh fare emocionet e mia

10. Kontrolli i sjelleve

- ☐ Shpesh veproj në mënyrë aq të nxituar dhe impulsive sa që shkakton probleme serioze
- ☐ Nganjëherë veproj sipas impulsit pa i marrë parasysh pasojat e atij veprimi, gjë që shkakton probleme
- ☐ Në përgjithësi jam në gjendje të jem spontan përderisa ushtroj një kontroll të përshtatshëm mbi veprimet e mia
- ☐ Nganjëherë jam aq i/e përmbajtur në veprimet e mia sa që nuk e nxjerr nga jeta atë që e nxjerrin të tjerët
- ☐ Shpesh jam aq tejet i/e përmbajtur në veprimet e mia sa që nuk mund të nxjerr pothuajse asgjë nga jeta

11. Përjetime e realitetit gjatë stresit

- ☐ Përjetimi im i situatave është zakonisht i saktë kur jam në duke përjetuar stres
- ☐ Përjetimi im i situatave është deri diku i shtrembëruar kur jam duke përjetuar stres (p.sh., e pres të ndodhë më e keqja, ndihem i/e refuzuar nga të tjerët kur ata më kritikojnë)
- ☐ Nganjëherë e humbas kontaktin me atë që është e vërtetë kur jam duke përjetuar stres (p.sh., jam dyshues/e, ndjehem i/e shkëputur nga realiteti, ose gjërat rreth meje më duken si në ëndërr)
- ☐ Shpesh e humbas kontaktin me realitetin kur jam duke përjetuar stres (p.sh., jam dyshues/e deri në ekstrem, shoh ose dëgjoj gjëra që njerëzit e tjerë nuk mund t'i shohin ose t'i dëgjojnë, kam përjetime sikur jam jashtë trupit tim)

12. Lëndimi i vetes

- ☐ Unë nuk e lëndoj veten asnjëherë
- ☐ Unë e lëndoj veten rrallë
- ☐ Unë e lëndoj veten ndonjëherë
- ☐ Unë e lëndoj veten shpesh

13. Lëndimi i të tjerëve (me ose pa dashje)

- ☐ Unë nuk i lëndoj të tjerët asnjëherë
- ☐ Unë i lëndoj të tjerët rrallë
- ☐ Unë i lëndoj të tjerët ndonjëherë
- ☐ Unë i lëndoj të tjerët shpesh

14. Duke menduar për përgjigjet tuaja në fushat më sipër, sa shpesh shkaktojnë ato probleme në fusha të rëndësishme të jetës suaj (p.sh., në fushën personale, familje, sociale, në edukim, në punë)?

- ☐ Aspak
- ☐ Pak
- ☐ Deri diku
- ☐ Shumë

PDS-ICD-11

Shkalla e Ashpërsisë së Çrregullimit të Personalitetit sipas ICD-11 (PDS-ICD-11)

Instruktionet e pikëzimit

Artikujt 1-10 pikëzohen 2 – 1 – 0 – 1 – 2

Artikujt 11-14 pikëzohen 0 – 1 – 2 – 3

Shkalla PDS-ICD-11 pikëzohet duke i mbledhur pikët për 14 artikujt (pikët shkojnë prej 0 deri në 32).

Shënim. Në rast se respondenti e selekton më shumë se një përgjigje për një artikull, numërohet përgjigja me pikëzimin më të lartë.

Si të citohet PDS-ICD-11

Bach, B., Brown, T. A., Mulder, R. T., Newton-Howes, G., Simonsen, E., & Sellbom, M. (2021). Development and Initial Evaluation of the ICD-11 Personality Disorder Severity Scale: PDS-ICD-11. *Personality and Mental Health*. <https://doi.org/10.1002/pmh.1510>

Zhvillimi dhe Përkthimi

Shkalla PDS-ICD-11 është zhvilluar sipas Përshkrimeve Klinike dhe Udhëzimeve Diagnostike (CDDG) të WHO ICD-11 për përcaktimin e pranisë dhe ashpërsisë së shqetësimeve të personalitetit. Kjo është arritur përmes bashkëpunimit në mes të këtyre trupave:

Departamenti i Psikologjisë
Laboratori i Personalitetit, Psikopatologjisë dhe Matjes (PPM)
Universiteti i Otago
Dunedin 9016, Zelandë e Re

Njësia për Hulumtime Psikiatrike
Qendra për Hulumtime të Çrregullimeve të Personalitetit (CPDR)
Shërbimet e Shëndetit Mendor, Rajoni i Zelandës
Slagelse 4200, Danimarkë

Përkthimi dhe përdorimi i PDS-ICD-11 lejohet pas marrëveshjes me autorët:
Bo Bach (bbpn@regionsjaelland.dk) dhe/ose Martin Sellbom (martin.sellbom@otago.ac.nz)

Translated by Jon Konjufca (jon.konjufca@uni-pr.edu) and Natyra Agani-Destani (natyra.agani@uni-pr.edu)